KËRKESË
Nr. 417, datë 20.1.2017

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Zgjerimi i varrezave publike, faza e katërt, Njësia Administrative Portëz, Mbyet, Patos–Fshat", Fier.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Fier.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 7,464,000 (shtatë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I
ZHVILLIMIT URBAN
Alfred Dalipi

VLERESIME PARAPRAKE PER PASURITE PRONE PRIVATE QE DO TE SHPRONESOHEN PER EFEKT TE REALIZIMIT TE PROJEKTEVE PER INTERES PUBLIK

Lista emerore e pronareve, pasurite e te cileve do te shpronesohen per realizimin e projektit "Zgjerimi I Varrezave publike , faza e IV, Fier , dhe Njesia Administrative Portez

Nr.	Emer Mbiemer	Zona Kadastrale	Nr. Pasurise	Sip. Pergj. Toke/Are (m^2)	Sip. Prekur Toke /Are (m^2)	Cmimi per truallin (leke / m^2)	Vlera e truallit (leke)	Vlera e Pergjith. (leke)	Gjendja juridike e pasurise
1	Ibrush Riza Hoxha	2637	288/142	3117	3117	1,000	3,117,000	3,117,000	Konfirmim nga Z.V.R.P.P
2	Mylazim Riza hoxha	2637	288/117	3467	3467	1,000	3,467,000	3,467,000	Konfirmim nga Z.V.R.P.P
3	Mynyr Veli Beqiraj	2891	392/31	2,000	2000	440	880,000	880,000	Konfirmim nga Z.V.R.P.P
								7,464,000	

Vleresimi paraprak eshte bere duke u bazuar ne VKM Nr.873,date 14/12/2011"Per shpronesimin per interes publik,per pasurite prone private qe preken nga zgjerimi i varrezave publike faza e III " ne Bashkine Fier dhe VKM nr. 514, date 30/07/2014 "Mbi miratimin e vleres se prones per secilin Qark ne Republiken e Shqiperise ,mbi bazen e te cilit eshte miratuar VKB. Nr.9, date 20/01/2016 .